18. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas Pretendimit 17 ku mostra biologjike është një mostër tumori dhe mostra analizohet me sekuencim gjenomik/ADN-je.
19. Komponimi ose kripa e tij për përdorim sipas Pretendimit 17 ose 18 ku mostra përftohet nga pacienti përpara administrimit të parë tek pacienti të komponimit ose të kripës së tij.
20. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas secilit prej Pretendimeve 13 deri në 19 ku një pacient është përzgjedhur për trajtim duke pasur të paktën një mutacion çaktivizues në gjenin *ARID1A*.
21. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas secilit prej pretendimeve 13 deri në 19 ku një pacient është përzgjedhur për trajtim duke pasur të paktën një mutacion çaktivizues në gjenin *KMT2C*.
22. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas secilit prej Pretendimeve 13 deri në 19 ku një pacient është përzgjedhur për trajtim duke pasur të paktën një mutacion çaktivizues në gjenin *KMT2D*.
23. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas secilit prej Pretendimeve 13 deri në 19 ku një pacient është përzgjedhur për trajtim duke pasur të paktën një mutacion çaktivizues në gjenin *RBI*.
24. Komponimi ose kripa e tij për tu përdorur sipas secilit prej Pretendimeve 13 deri në 23 ku komponimi ose kripa e tij administrohet tek pacienti në një dozë prej afërsisht 1 mg deri në 2 g.

(11) **11131**

(97) EP3548092 / 06/07/2022

(96) 17876484.1 / 29/11/2017

(22) 15/07/2022

(21) AL/P/ 2022/384

(54) **PËRBËRJE RMP DHE METODAT E PËRDORIMIT**

18/10/2022

(30) 201662428155 P 30/11/2016 US

(71) University of Miami and RXMP Therapeutics, LLC

1951 N.W. 7th Avenue, Miami, FL 33136, US ;790 N.W. 107th Avenue Suite 215, Miami, FL 33172, US

(72) AHN, Yeon, S. (7771 Palmetto Court, Pinecrest, FL 33156); JY, Wenche (11860 S.W. 81 Road, Miami, FL 33156); HORSTMAN, Lawrence, L. (5301 Pine Terrace, Plantation, FL 33317) ;PAMUKCU, Rifat (125 North 4th Street 306, Philadelphia, PA 19106)

(74) Krenar Loloçi

Rr. Ibrahim Rugova, P. 1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një përbërje që përfshin mikrogrimca të prejardhura nga qelizat e kuqe (RMPs) duke demonstruar aktivitetin e esterazë acetilkolinës (AchE) prej më pak se 350 pmol/min/106 grimca/mL.

2. Përbërja e pretendimit 1, ku RMPs demonstroi aktivitetin e esterazë acetilkolinë (AchE) prej më pak se 200 pmol/min/106 grimca/mL.

3. Përbërja e pretendimit 1 ose pretendimit 2, ku 20%-50% e RMPs në përbërje shfaq fosfatidilserinë.

4. Përbërja e pretendimit 3, ku 30%-45% të RMPs në përbërje shfaq fosfatidilserinë.

5. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-4, ku përbërja shkurton kohën deri në formimin fillestar të mpiksjes siç matet me tromboelastografi (TEG) në gjakun e plotë dhe plazmën me të paktën dy minuta.

6. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-5, ku diametri mesatar i RMPs është 0.40-0.6 mm.

7. Përbërja e pretendimit 6, ku diametri mesatar i RMPs është 0.40-0.5 mm.

8. Përbërja e pretendimit 7, ku diametri mesatar i RMPs është 0.47 mm.

9. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-8, ku densiteti i brendshëm i RMPs është më pak se 3.5% i densitetit të brendshëm të ruazave të kuqe të gjakut.

10. Përbërja e pretendimit 9, ku densiteti i brendshëm i RMPs është 0.5-3.0% të densitetit të brendshëm të tërësisë

qelizat e kuqe të gjakut të matura me sinjalin e shpërndarjes anësore të citometrisë së rrjedhës.

11. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-10, ku RMP-të prodhohen duke detyruar qelizat e kuqe të gjakut përmes një hapje për të prodhuar qelizat e kuqe të këputura të gjakut dhe duke fragmentuar më tej qelizat e kuqe të gjakut të këputura nga bombardimet në një sipërfaqe të fortë.

12. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-11 për përdorim në një metodë për trajtimin e gjakderdhjes së tepërt në një subjekt, ku metoda përfshin administrimin e përbërjes te subjekti.

13. Përbërja për përdorim të pretendimit 12, ku gjakderdhja e tepërt shkaktohet nga trombocitopenia ose mosfunksionimi i trombociteve.

14. Përbërja për përdorim të pretendimit 13, ku mosfunksionimi i trombociteve shkaktohet nga trajtimi me medikamente.

15. Përbërja për përdorim të pretendimit 12, ku gjakderdhja e tepërt shkaktohet nga një antikoagulant, opsionalisht Coumadin, heparina me peshë të ulët molekulare, një frenues i kompleksit të protrombinazës, një frenues i FXa ose një frenues i trombinës.

(11) **11132**

(97) EP3420284 / 20/04/2022

(96) 17755882.2 / 22/02/2017

(22) 14/07/2022

(21) AL/P/ 2022/385

(54) **STRUKTURË EKOLOGJIKE PËR PËRMIRËSIMIN TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË**
18/10/2022

(30) 20165135 22/02/2016 FI

(71) Suomen Ilmastointi Ja Savunpoisto Oy

Punasillantie 28, 40950 Muurame, FI

(72) TOPPINEN, Esa (c/o Suomen Ilmastointi Ja Savunpoisto OyPunasillantie 28, 40950 Muurame)

(74) Krenar Loloçi

Rr. Ibrahim Rugova, P. 1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një strukturë për reduktimin e kosumit të energjisë të një pompë nxehtësie e tipit ndarës (8, D, B) tek një kontrollues nxehtësie, ku pompa e nxehtësisë së strukturës përmban:

- një pjesë të parë për trajtimin e nxehtësisë (B), kokë të brendshme si njësi brenda banese (B), të strukturuar për të prodhuar një efekt të parë kontrolli nxehtësie brenda një ndërtese, duke transferuar nxehtësinë e ajrit të brendshëm në një vend të ndërmjetëm (D) në qarkullimin e parë të

shkëmbimit të nxehtësisë në kokën e brendshme si njësi brenda banese,
- një pjesë e dytë për trajtimin e nxehtësisë (8), kokë e jashtme si një njësi jashtë banese (8), e strukturuar të prodhojë një efekt të dytë kontrolli nxehtësie jashtë ndërtesës (A), duke transferuar nxehtësinë jashtë nga vendi i ndërmjetëm (D) në qarkullimin e shkëmbimit të nxehtësisë, që është më vete nga qarkullimi i parë i shkëmbimit të nxehtësisë së përmendur, por është në një komunikim shkëmbimi nxehtësie, me anën e vendit të ndërmjetëm të përmendur (D), me kokën e brendshme të përmendur si njësi brenda banese (B), për transferim të nxehtësisë, ndërmjet kokës së brendshme të përmendur si njësi brenda banese (B) dhe kokës së jashtme të përmendur si njësi jashtë banese, me anën e vendit të ndërmjetëm (D), ku strukturimi përmban më tej të paktën një kanal ajri të kondicionuar (7) lidhjen për një kanal ajri të kondicionuar (7), për të strukturuar montimin e kanalit të ajrit të kondicionuar të përmendur nëpërmjet lidhjes së përmendur, për të çuar ajrin e brendshëm nga ajri brenda banese i banjës (2) tek koka e jashtme si njësi jashtë banese (8) për një efekt termal që shkaktohet në të nga banja brenda banese çuar nga ajri brenda banese (A,2);

strukturë që **karakterizohet në atë që** në strukturë ka një strukturë çelës valvol, që përmban çelësa dhe valvola elektro-mekanikë të strukturuar për të kontrolluar rrymën e ajrit të brendshëm dhe/ose drejtimin e rrymës në vendin e ndërmjetëm dhe/ose vendosjen e magnitudës, të bazuar të paktën në njërën prej sasive vijuese observuese/matëse:

- temperatura sipas kokës së brendshme si vend i njësisë brenda banese
- temperatura sipas kokës së jashtme si vend i njësisë jashtë banese,
- temperatura e vendit të ndërmjetëm,
- presioni sipas kokës së brendshme si vend i njësisë brenda banese
- presioni sipas kokës së jashtme si vend i njësisë jashtë banese,
- pikë kondensimi sipas kokës së brendshme si vend i njësisë brenda banesës
- pikë kondensimi sipas kokës së jashtme si vend i njësisë jashtë banese,
- shkalla e rrymës në vendin e ndërmjetëm,
- presioni i vendit të ndërmjetëm,
- koha dhe
- sinjali i një sensori lëvizjeje si një sinjal i pranisë së përdoruesit,

struktura më tej përmban një qendër kontrolli (C) për kontrollin me anën e një paisjeje të lëvizshme, në ko-operim me aktivizuesit e strukturës për të kontrolluar funksionimin e strukturës nëpërmjet ndërveprimit të përdoruesit të pajisjes së lëvizshme (UI), mbi një lidhje rrjeti informacioni me qendrën e kontrollit të përmendur (C), ku qendra e kontrollit të strukturës strukturohet të kontrollojë aktivizuesit sipas të dhënave matëse të përfuara nga sensorët bazuar në parimin furnizimit me të dhëna, në mënyrë që të paktën njëri prej aktivizuesve është i seleksionueshëm nga vijuesit: valvolat elektromekanike, çelësat, tharësit, vetilatorët, fryrësit, dhe/ose pompat, çelësat dhe aktivizuesit që kontrollojnë ushqimin me energji të sapo përmendurëve, për më tepër rryma e ajrit në kanalin e ajrit të kondicionuar (7) kontrollohet nga aktivizuesi siç është një ventilator dhe/ose mbyllësi mekanik, kur ky ka aparate elektronike kontrolluese të përshtatshme për kontrollin e tyre.

2. Struktura sipas një pretendimi 1, **që karakterizohet në atë që** struktura përmban një lidhje shtesë tek fryrësi dhe/ose ventilatori për montimin e tij në konformitet me kanalin e ajrit të kondicionuar të përmendur (7).

3. Struktura sipas një pretendimi 1 ose 2, **që karakterizohet në atë që** struktura përmban të paktën një lidhje të tillë tek një fryrës dhe/ose ventilator që ndodhet në një fund të ajrit brenda banese të banjës (2) dhe/ose kokë të jashtme si njësi jashtë banese të banjës (8) dhe/ose atje ndërmjet tyre në kanalin e ajrit të kondicionuar (7).

4. Struktura sipas secilës prej pretendimeve të mëparshme, **që karakterizohet në atë që** struktura përmban një qendër kontrolli (C) për kontrollin me anën e një pajisjeje të lëvizshme, në ko-operim me

aktivizuesit e strukturës për të kontrolluar funksionimin e strukturës nëpërmjet ndërveprimit të përdoruesit të pajisjes së lëvizshme (UI), mbi një lidhje rrjeri informacioni të qendrës së kontrollit të përmendur (C).

5. Një pompë nxehtësie, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë përmban një strukturë sipas secilit prej pretendimeve 1-4.

6. Pompë nxehtësie sipas pretendimit 5, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë ka një kokë të brendshme si njësi brenda banese (B) dhe një kokë të jashtme si njësi jashtë banese (8) dhe një kanal për qarkullimin e ndërmjetëm të transferimit të nxehtësisë ndërmjet kokës së brendshme të përmendur si njësi brenda banese (B) dhe kokës së jashtme si njësi jashtë banese (8), që përmbajnë më tej në kokën e tij të jashtme si njësi jashtë banese (8) një lidhje për një kanal ajri të kondicionuar (7) për çuarjen e ajrit brenda banese nga ajri brenda banese të banjës (2) tek koka e jashtme si njësi jashtë banese (8) për të siguruar një efekt termal me anën e ajrit brenda banese (A, 2) që kalon në kanalën e përmendur të ajrit të kondicionuar (7).

7. Pompë nxehtësie sipas pretendimit 5 ose 6, **që karakterizohet në atë që** koka e jashtme e përmendur si njësi jashtë banese dhe koka e brendshme e përmendur si njësi brenda banese integrohen së bashku në një tërësi në të njëjtin shasi, ku ajri brenda banese i banjës (2) është strukturuar në lidhje me shasinë dhe/ose nga hapësira e apartamentit (A) ose një pjesë (1) e saj.

8. Pompë nxehtësie sipas pretendimit 5, 6 ose 7, **që karakterizohet në atë që** të paktën njëra kokë e brendshme e përmendur si njësi brenda banese (B) dhe njëra kokë e jashtme e përmendur si njësi jashtë banese (8) izolohehen termikisht nga tërësia e përmendur, për ruajtjen e temperaturës së substancës së përdorur në kanalën e ajrit të kondicionuar (7) ndërmjet kokës së brendshme të përmendur si njësi brenda banese (B) dhe kokës së jashtme të përmendur si njësi jashtë banese (8), në temperaturën sipas ajrit brenda banese të banjës (2) përpara se sa rryma të hyjë në kokën e jashtme si njësi jashtë banese (8).

9. Pompë nxehtësie sipas pretendimit 5, 6, 7 ose 8, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë përmban një strukturë valvoleje (V) me qëllim që të kompensojë në mënyrë të ndërsjellë vendet në procesin e qarkullimit të kokës së brendshme si njësi brenda banese (B) dhe kokës së jashtme si njësi jashtë banese (8) në qarkullimin e ndërmjetëm.

10. Pompë nxehtësie sipas secilit prej pretendimeve 5 - 9, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë përmban një njësi dehidratuese të strukturuar të heqë ujin nga rryma e kanalit të ajrit të kondicionuar (7), në drejtimin e rrymës, përpara kokës së jashtme të përmendur si njësi jashtë banese (8) të pompës së nxehtësisë.

11. Pompë nxehtësie sipas secilit prej pretendimeve 5 - 10, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë përmban në kokën e saj të jashtme si njësi jashtë banese (8) një lidhje të kanalit të ajrit të kondicionuar për një kanal ajri të kondicionuar (7), për të lëvizur ajrin brenda banese nga ajri brenda banese të banjës (2) tek koka e jashtme si njësi jashtë banese (8) për sigurimin e një efekti termal në kokën e jashtme si njësi jashtë banese (8) të pompës së nxehtësisë, për përmirësimin e sasisë-COP të pompës së nxehtësisë.

12. Pompë nxehtësie sipas secilit prej pretendimeve 5 - 11, **që karakterizohet në atë që** pompa e nxehtësisë përmban një qark vet-diagnostikues për observimin e nevojës për mirëmbajtje dhe dhe shërbim dhe/ose për raportimin mbi një rrjet të tillë informacioni ndërmjet qendrës së kontrollit dhe terminalit të përdorur (C, UI).

13. Pompë nxehtësie sipas secilit prej pretendimeve 5 - 12, **që karakterizohet në atë që** të paktën njëra kokë e jashtme që vijon si njësi jashtë banese (8) dhe njëra kokë e brendshme që vijon si njësi brenda banese (B) përmban tek ajo (8, B) një lidhje për marrje ajri (ivv) për çuarjen e ajrit nëpërmjet saj (8, B), ku lëvizja e ajrit nëpërmjet kokës së brendshme si njësi brenda banese (B) e çon ajrin që të drejtohet në hapësirën brenda banesës, por nëpërmjet kokës së jashtme si njësi jashtë banese (8) në hapësirën jashtë banese.

14. Pompë nxehtësie sipas secilit prej pretendimeve 5 -13, **që karakterizohet në atë që** ajo strukturohet për nxehtësi, ftohje dhe/ose ruajtjen e temperaturës në vlerën e paracaktuar për një hapësirë brenda banese të një ndërtese.

(11) **11113**

(97) EP3119410 / 04/05/2022

(96) 15728593.3 / 17/03/2015

(22) 14/07/2022

(21) AL/P/ 2022/386

(54) **FEROMONE QETËSUESE TË MACEVE**

13/10/2022

(30) 201461954771 P 18/03/2014 US

(71) Institut de Recherche en Semiochimie et Ethologie Appliquée

Quartier Salignan, 84400 Apt, FR

(72) PAGEAT, Patrick (Le Fénière du Plan - Route de Saint-Saturnin, F-84400 Apt)

(74) Krenar Loloçi

Rr. Ibrahim Rugova, P. 1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një kompozim me aplikim lokal për përdorim në trajtimin e stresit, ankthit, agresivitetit në një mace, kompozimi me aplikim lokal i sipërpërmendur që përfshin mes 15% deri në 25% (w%/w%) metil palmitat, mes 10% deri në 27% (w%/w%) metil linoleat, mes 25% deri në 35% (w%/w%) metil oleat, mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil stearat, mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil laurat dhe mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil miristat, dhe një mjet për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja.

2. Kompozimi me aplikim lokal për përdorim sipas Pretendimit 1, ku kompozimi me aplikim lokal përfshin 22% (w%/w%) metil palmitat, 17% (w%/w%) metil linoleat, 28% (w%/w%) metil oleat, 11% (w%/w%) metil stearat, 11% (w%/w%) metil laurat dhe 11% (w%/w%) metil miristat, dhe një mjet për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja.

3. Kompozimi me aplikim lokal për përdorim sipas çdo njërit prej Pretendimeve 1 deri në 2, ku në kompozimin me aplikim lokal, mjeti i sipërpërmendur për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja është një glikol eter.

4. Kompozimi me aplikim lokal për përdorim sipas Pretendimit 3, ku në kompozimin me aplikim lokal, mjeti i sipërpërmendur për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja është zgjedhur ndër: dietilen glikol monoetil eter, dietilen glikol monometil eter, dietilen glikol monopropil eter, dietilen glikol monoisopropil eter, dietilen glikol monobutil eter, dietilen glikol monofenil eter, dietilen glikol monobenzil eter, dietilen glikol dimetil eter, etilen glikol monometil eter, etilen glikol monoetil eter, etilen glikol monopropil eter, etilen glikol monoisopropil eter, etilen glikol monobutil eter, etilen glikol monofenil eter, etilen glikol monobenzil eter dhe etilen glikol dimetil eter.

5. Kompozimi me aplikim lokal për përdorim sipas çdo njërit prej Pretendimeve 1 deri në 4, ku kompozimi me aplikim lokal më tej përfshin një mbushës jotoksik.

6. Kompozimi me aplikim lokal për përdorim sipas Pretendimit 5, ku në kompozimin me aplikim lokal, mbushësi jotoksik i sipërpërmendur është zgjedhur nga grupi i acideve yndyrore, alkooleve, aminave, skualenit, glicerolit dhe përzierje të tyre.

7. Një kompozim me aplikim lokal për përdorim sipas çdo njërit prej Pretendimeve 1 deri në 6, ku kompozimi me aplikim lokal i sipërpërmendur është administruar çdo katërbëdhjetë ditë.

8. Një metodë për të realizuar lehtësimin social në një mace, metoda e sipërpërmendur që përfshin administrimin te macja e sipërpërmendur një kompozim me aplikim lokal që përfshin mes 15% deri në 25% (w%/w%) metil palmitat, mes 10% deri në 27% (w%/w%) metil linoleat, mes 25% deri në 35% (w%/w%) metil oleat, mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil stearat, mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil laurat dhe mes 5% deri në 15% (w%/w%) metil miristat, dhe një mjet për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja.

9. Metoda sipas Pretendimit 8, ku kompozimi me aplikim lokal përfshin 22% (w%/w%) metil palmitat, 17% (w%/w%) metil linoleat, 28% (w%/w%) metil oleat, 11% (w%/w%) metil stearat, 11% (w%/w%) metil laurat dhe 11% (w%/w%) metil miristat, dhe një mjet për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja.

10. Metoda sipas çdo njërit prej Pretendimeve 8 deri në 9, ku në kompozimin me aplikim lokal, mjete i sipërpërmendur për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja është një glikol eter.

11. Metoda sipas Pretendimit 10, ku në kompozimin me aplikim lokal, mjete i sipërpërmendur për aplikimin perkutan të lokalizuar te macja është zgjedhur ndër: dietilen glikol monoetil eter, dietilen glikol monometil eter, dietilen glikol monopropil eter, dietilen glikol monoisopropil eter, dietilen glikol monobutil eter, dietilen glikol monofenil eter, dietilen glikol monobenzil eter, dietilen glikol dimetil eter, etilen glikol monometil eter, etilen glikol monoetil eter, etilen glikol monopropil eter, etilen glikol monoisopropil eter, etilen glikol monobutil eter, etilen glikol monofenil eter, etilen glikol monobenzil eter dhe etilen glikol dimetil eter.

12. Metoda sipas çdo njërit prej Pretendimeve 1 deri në 11, ku kompozimi me aplikim lokal më tej përfshin një mbushës jotoksik.

13. Metoda sipas Pretendimit 12, ku në kompozimin me aplikim lokal, mbushësi jotoksik i sipërpërmendur është zgjedhur nga grupi i acideve yndyrore, alkooleve, aminave, skualenit, glicerolit dhe përzierje të tyre.

14. Metoda sipas çdo njërit prej Pretendimeve 1 deri në 13, ku kompozimi me aplikim lokal i sipërpërmendur është administruar çdo katërbëdhjetë ditë.

(11) **11114**

(97) EP3223853 / 22/06/2022

(96) 15794625.2 / 27/10/2015

(22) 14/07/2022

(21) AL/P/ 2022/387

(54) **MATERIALE DHE METODA QË LIDHEN ME LIDHËSIT PËR PËRDORIM NË KONJUGATËT E BARNAVE PROTEINIKE**

13/10/2022

(30) 201419108 27/10/2014 GB and 201503012 23/02/2015 GB

(71) Iksuda Therapeutics Limited

The Biosphere Draymans Way, Newcastle Helix, Newcastle Upon Tyne NE4 5BX, GB


(72) BAXTER, Anthony David (5 Millers View, Much Hadham Hertfordshire SG10 6BN); BIRCHALL, Christopher Michael (13A Salcombe Road, London E17 8JH); MANSELL, David James (119 Regent Farm Road, Newcastle Upon Tyne Tyne and Wear NE3 3HD); MYSLIWY, Justyna Helena (Colombo Square 60, Worsdell Drive, Gateshead NE8 2DF); THIRLWAY, Jenny (110 Eastfield Avenue, Haxby, York, YO32 2EY)

(74) Krenar Loloçi

Rr. Ibrahim Rugova, P. 1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një konjugat i barnave proteinike i formuar nga reaksioni i një proteine globulare, një lidhësi dhe një bari, ku proteina globulare është një antitrop ose fragment i saj që përfshin të paktën një grup reaktiv tiol dhe ku lidhësi përfshin një azot që përmban unazë heterociklike aromatike që përfshin një zëvendësues vinil të përfaqësuar nga formula e mëposhtme,



ku:

R₁ është zgjedhur nga;

- (CH₂)_n - C(O)- R, ose
- (CH₂)_m - S - (CH₂)_n - C(O) - R, ose
- (CH₂)_n - CH(CO₂R)₂, ose,
- (CH₂)_m - S - (CH₂)₂CH(CO₂R)₂, ose,

ku,

- R₂ është zgjedhur nga grupi i njëjtë i molekulave si R₁, hidrogjen, ose një grup alkil,
- n është ndonjë numër i plotë nga 0 deri në 10,
- m është ndonjë numër i plotë mes 0 dhe 10,
- R është një hidroksid (OH), aminë ose një grup poli-(alkilen glikol),

ose ku R₁ është -CH₂-CH(C(O)-NH-PEG)₂ dhe R₂ është një grup metil;

ku proteina globulare është konjuguar te lidhësi përmes konjugimit të grupit tiol te zëvendësuesi vinil; dhe

ku bari është konjuguar te lidhësi përmes grupit R₁, ose kur R₂ është zgjedhur nga grupi i njëjtë i molekulave si R₁, bari është konjuguar te lidhësi përmes grupit R₂, ose përmes grupit R₁ dhe grupit R₂.

2. Konjugati i barnave proteinike sipas pretendimit 1 ku antitrupi është një antitrop monoklonal.
3. Konjugati i barnave proteinike sipas ndonjë pretendimi të mëparshëm ku bari është një citotoksinë ose një peptid ose polipeptid terapeutik.
4. Konjugati i barnave proteinike sipas pretendimit 3 ku citotoksina është një material citotoksik biologjikisht aktiv.
5. Konjugati i barnave proteinike sipas pretendimit 3 ose pretendimit 4 ku citotoksina është një bar antikancer.
6. Konjugati i barnave proteinike sipas ndonjë pretendimi të mëparshëm, ku lidhësi përfshin një grup poli-(alkilen glikol), në mënyrë të preferuar ku grupi poli-(alkilen glikol) është një polietilen glikol (PEG).
7. Konjugati i barnave proteinike sipas pretendimit 6, ku struktura poli-(alkilen glikol) është siguruar me një ose më shumë grupe funksionale reaktive që inkludojnë grupe hidroksi, aminë, acid karboksilik, alkil halid, azid, suksinimidil ose tiol.
8. Konjugati i barnave proteinike sipas ndonjë pretendimi të mëparshëm i cili më tej përfshin një lidhës zgjatues, në mënyrë të preferuar ku lidhësi zgjatues i sipërpërmendur është enzimë e copëtueshme.
9. Një metodë e prodhimit të konjugatit të barit proteinik të ndonjë pretendimi të mëparshëm, e cila përfshin kontaktimin e proteinës me lidhësin i cili është i lidhur te bari.
10. Një metodë e prodhimit të konjugatit të barit proteinik të çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 8, e cila përfshin kontaktimin e proteinës me lidhësin, dhe më pas kontaktimin e lidhësit me barin.
11. Metoda sipas pretendimeve 9 ose 10, që inkludon një hap fillestar të reagimit të një lidhësi pararendës që përfshin një azot që përmban unazë heterociklike aromatike që një zëvendësues vinil me një molekulë poli-(alkilen glikol) për të prodhuar lidhësin.
12. Metoda sipas çdo njërit prej pretendimeve 9 deri në 11, më tej që përfshin një hap fillestar të modifikimit të proteinës për të prodhuar një polipeptid variant që ka një grup tiol në një ose më shumë pozicione të dëshiruara të polipeptidit.
13. Konjugati i barnave proteinike sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8 për përdorim në terapi.

(11) **11117**

(97) EP3179992 / 11/05/2022

(96) 15762756.3 / 11/08/2015

(22) 22/06/2022

(21) AL/P/ 2022/388

(54) KOMBINIMET TERAPEUTIKE TË NJË INHIBITORI BTK, NJË INHIBITORI PD-1 DHE/OSE NJË INHIBITORI PD-L1

13/10/2022

(30) 201462035812 P 11/08/2014 US; 201462088357 P 05/12/2014 US; 201562115489 P 12/02/2015 US and 201562181164 P 17/06/2015 US

(71) Acerta Pharma B.V.

Kloosterstraat 9, 5349 AB Oss, NL


(72) BARF, Tjeerd (St. Luciastraat 7, 5371 AS Ravenstein); HAMDY, Ahmed (640 Henry Cowell Drive, Santa Cruz, CA 95060); ROTHBAUM, Wayne (101 Central Park West PHC, New York, NY 10023); IZUMI, Raquel (3437 Brittan Avenue, San Carlos, CA 94070); LANNUTTI, Brian (627 Glencrest Place, Solana Beach, CA 92075); COVEY, Todd (3437 Brittan Avenue, San Carlos, CA 94070); ULRICH, Roger (22525 SE 46th Place, Sammamish, WA 98075); JOHNSON, Dave (694 St. Andrew Circle, Aptos, CA 95033); KAPTEIN, Allard (Marten van Rossemsingel 51, 5301 HB Zaltbommel)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një kombinim farmaceutik që përfshin (1) një frenues të vdekjes së programuar 1 (PD-1) ose një frenues të ligandit të vdekjes së programuar 1 (PD-L1) dhe (2) një frenues të kinaze tirozines së Bruton (BTK) ose një kripë të tij farmaceutikisht të pranueshme për përdorim në trajtimin e kancerit të një subjekti njerëzor, ku frenuesi BTK zgjidhet nga grupi që përbëhet nga:



frenuesi PD-1 është pembrolizumab, dhe frenuesi PD-L1 është durvalumab.

2. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 1, ku kombinimi përfshin frenuesin PD-1 pembrolizumab.

3. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 1, ku kombinimi përfshin frenuesin PD-L1 durvalumab.

4. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit pretendim të mëparshëm, ku kombinimi më tej përfshin një antitrop anti-CD20 të zgjedhur nga grupi i përbërë nga rituximab, obinutuzumab,

ofatumumab, veltuzumab, tositumomab, ¹³¹I-tositumomab, ibritumomab, ⁹⁰Y-ibritumomab, ¹¹¹In-ibritumomab dhe ibritumomab tiuxetan.

5. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit pretendim të mësipërm, ku kanceri është një malinj hematologjik i qelizave B, i zgjedhur nga grupi që përbëhet nga leucemia limfocitare kronike (CLL), leucemia limfocitare e vogël (SLL), limfoma jo-Hodgkin (NHL), limfoma e qelizave B të mëdha të difuzuara (DLBCL), limfoma folikulare (FL), limfoma e qelizave të mantelit (MCL), limfoma Hodgkin, leucemia limfoblastike akute e qelizave B (B-ALL), limfoma e Burkitt-it, makroglobulinemia e Waldenström (WM), mieloma e shumëfishtë (MM), sindromi mielodisplastik dhe mielofibroza.

6. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit pretendim të mësipërm, ku kanceri është leucemia limfocitare kronike (CLL).

7. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit pretendimi të mësipërm, ku kanceri është limfoma e qelizave B të mëdha të difuzuara (DLBCL).

8. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit pretendim të mësipërm, ku kanceri është limfoma e qelizave të mantelit (MCL).

9. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku përdorimi përfshin administrimin e inhibitorit PD-1 ose PD-L1 dhe frenuesit BTK njëkohësisht në përbërje të ndara.

10. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku përdorimi përfshin administrimin e frenuesit PD-1 ose PD-L1 dhe frenuesit BTK në kohë të ndryshme në kompozime të ndara.

11. Kombinimi farmaceutik për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku përdorimi përfshin administrimin e frenuesit PD-1 ose PD-L1 dhe frenuesit BTK në një kompozim në të cilën dy ose më shumë përbërës farmaceutikë aktivë janë të pranishëm.

(11) **11119**

(97) EP3523310 / 18/05/2022

(96) 17788131.5 / 05/10/2017

(22) 01/08/2022

(21) AL/P/ 2022/389

(54) **POLIMORFET KRISTALORE TE NJË AGONISTI TË RECEPTORIT MUSKARINIK TË ACETILKOLINËS**

13/10/2022

(30) 16192494 05/10/2016 EP

(71) NSC THERAPEUTICS GmbH

Willersdorferstr. 7, 8061 St. Radegund, AT


(72) FISHER, Abraham (Simthat Harozmarin 11, 5845727 Holon); BAR-NER, Nira (Bilu Street 77, 7534414 Rishon LeZion); WINDISCH, Manfred (Willersdorferstraße 6, 8061 St.Radegund)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një polimorf kristalor i Përbërjes A të formulës



ku polimorfi në fjalë është zgjedhur nga grupi që përbëhet nga

Forma III monohidrat

(i) që ka një model difraksioni të pluhurit me rreze X që përmban të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta (± 0.2) të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 12.3, 17.3, 17.5, 19.9, 21.6, 24.6, 26.3 dhe 35.4, dhe të lirë nga kulmet që kanë vlera 2-theta në rangun nga 10.8-11.9;

(ii) ku NMR e gjendjes së ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban të paktën një rezonancë që ka një nga vlerat e zhvendosjes kimike të mëposhtme siç shprehet në ppm në lidhje me TMS: 67.56, 54.60, 47.07, 41.49, 30.70 dhe 13.77;

(iii) ku NMR në gjendje së ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban një ndryshim në zhvendosjen kimike ndërmjet rezonancës që ka zhvendosjen kimike më të madhe dhe një rezonancë tjetër prej 107.3, 120.3, 127.9, 133.4, 144.2 ose 161.1;

(iv) ku spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristalore përmban të paktën një kulm absorbimi që ka një vlerë të zgjedhur nga 1039, 1353, 1369, 1388, 2918, 2974 dhe 3088 cm^{-1} ; dhe/ose

(v) ku forma kristalore shfaq një kulm endotermik shumë të gjerë në 58-94°C dhe një kulm endotermik me fillim në 133.7°C dhe një kulm në 134.9°C, siç matet me kalorimetrinë e skanimit diferencial (DSC),

Forma II anhidrike

(i) që shfaq një rreze X me një kristal të karakterizuar nga të dhënat e mëposhtme të rrezeve X me një kristal: $P2(1)$ $a=8.1416(13)$, ($\alpha=90^\circ$), $b=7.9811(12)$ ($\beta=90.761(2)^\circ$), $c=17.878(3)$, ($\gamma=90^\circ$), A , $T=173(1)\text{K}$;

(ii) ka një model difraksioni të pluhurit me rreze X që përmban të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta (± 0.2) të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 9.9, 10.8, 11.8, 11.9, 14.8, 16.2, 18.2, 18.5, 19.8, 21.3, 22.4, 23.9, 29.2, 29.7 dhe 33.1;

(iii) ku spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristaline përmban të paktën një kulm absorbimi që ka një vlerë të zgjedhur nga 1906, 1340, 1447, 2869, 2901, 2951, dhe 3006-3012 cm^{-1} ;

(iv) ku NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban të paktën një rezonancë që ka një nga vlerat e zhvendosjes kimike të mëposhtme siç shprehet në ppm në lidhje me TMS: 175.0; 65.3, 64.0; 45.8, 45.0; 49.3, 43.6; 39.5, 38.8; 28.9, 26.0; 15.4, 14.8;

(v) ku NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban një ndryshim në zhvendosjen kimike ndërmjet rezonancës që ka zhvendosjen kimike më të madhe dhe një rezonancë tjetër prej 109.7 ose 111; 129.2 ose 130.0; 122.7; 125.7; 131.4; 135.5; 136.2; 146.1 ose 149.0; dhe 159.6 ose 160.2; dhe/ose

(vi) ku forma kristalore ka një kulm endotermik me fillim në 134.2°C dhe kulm në $135.4^{\circ}\text{C} \pm 0.2^{\circ}\text{C}$ dhe në mënyrë thelbësore nuk ka kulm endotermik ndërmjet 106°C dhe 110°C , duke i munguar një kulm endotermik në rangun prej rreth 50°C deri në rreth 120°C , siç matet nga DSC,

Forma I monohidrate

(i) ka një model difraksioni të pluhurit me rreze X që përmban të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta (± 0.2) të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 8.8, 12.3, 17.5, 19.9, 21.6, 23.5, 24.5, 26.3, 28.8, 31.6, por i mungon të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta 17.3, 17.9, 21.9, 24.9, 29.3, 30.8 dhe 33.4 dhe është në mënyrë thelbësore pa kulme që kanë vlera 2-theta në rangun prej 10.8-11.9;

(ii) ku spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristalore përmban të paktën një kulm absorbimi që ka një vlerë të zgjedhur nga 1352, 1369 dhe 1387 cm^{-1} ; dhe/ose

(iii) ku forma kristaline shfaq një kulm endotermik në 107.1°C (fillimi në 104.85°C) dhe 136.17°C (fillimi në 133.41°C) siç matet me kalorimetrinë e skanimit diferencial (DSC); dhe në mënyrë opsionale

(iv) ku NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban të paktën një rezonancë që ka një nga vlerat e zhvendosjes kimike të mëposhtme siç shprehet në ppm në lidhje me TMS: 67.09, 54.08, 46.59, 40.97, 30.15 dhe 13.27; dhe/ose

(v) ku NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristaline përmban një ndryshim në zhvendosjen kimike ndërmjet rezonancës që ka zhvendosjen kimike më të madhe dhe një rezonancë tjetër prej 107.3, 120.3, 127.8, 133.4, 144.2 ose 161.1.

2. Polimorfi kristalor i pretendimit 1, ku polimorfi është *Forma II* polimorfe.

3. Forma II polimorfe kristalore e pretendimit 2, ku

(a) forma kristalore **karakterizohet më tej nga** të dhënat e mëposhtme: Vëllimi= $1161.6(3)\text{ \AA}^3$, $Z=4$, $F(000)=464$, Dendësia e llogaritur, $D_c=1.226\text{ Mg/m}^3$, Koeficienti i absorbimit, $\mu=0.251\text{ mm}^{-1}$;

(b) modeli difraksionit të pluhurit me rreze X përmban të paktën dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë ose të gjitha vlerat e mëposhtme 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 9.9, 10.8, 11.8, 11.9, 14.8, 16.2, 18.2, 18.5, 19.8, 21.3, 22.4, 23.9, 29.2 dhe 29.7, 33.0, 33.1;

(c) modeli difraksionit të pluhurit me rreze X përfshin të paktën një kulm shtesë në një kënd difraksioni 2θ të zgjedhur nga grupi i përbërë nga 14.8° dhe 19.8° dhe/ose të zgjedhur nga grupi i përbërë nga 18.2° dhe 18.5° ;

(d) spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristalore përmban të paktën dy, tre, katër, pesë, gjashtë ose të gjitha majat e absorbimit që kanë një vlerë të zgjedhur nga 906, 1340, 1447, 2869, 2901, 2951 dhe $3006\text{-}3012\text{ cm}^{-1}$;

(e) NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban rezonanca që kanë të paktën dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë ose të gjitha vlerat e mëposhtme të zhvendosjes kimike të shprehura në ppm në lidhje me TMS: 175.0; 65.3, 64.0; 45.8, 45.0; 49.3, 43.6, 39.5; 38.8; 28.9, 26.0; 15.4, 14.8;

(f) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X përmban vlerat e mëposhtme 2-theta: 9.9, 10.8, 18.5, 19.8 ± 0.2 ; dhe ku NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C i formës kristalore përmban rezonancë që ka vlerat e mëposhtme të zhvendosjes kimike të shprehura në ppm në lidhje me TMS: 14.8, 15.4, 26.0, 28.9, 64.0, 65.3; dhe ku spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristalore përmban pikun e absorbimit që ka një vlerë të zgjedhur në rangun nga $1340\text{-}1362\text{ cm}^{-1} \pm 5\text{ cm}^{-1}$; dhe/ose

(g) forma polimorfe shfaq më pak se 1% humbje peshe siç përcaktohet nga analizat termogravimetrike (TGA) deri në një temperaturë prej rreth 110°C me një shpejtësi ngrohjeje prej rreth 3°C në minutë.

4. Polimorfi kristalor i pretendimit 1, ku polimorfi është polimorfi *Forma III*.


5. Polimorfi kristalor *Forma III* e pretendimit 4, ku

(a) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X përmban të paktën dy, tre ose të gjitha vlerat e mëposhtme 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 8.8, 12.30, 17.30, 17.50, 17.80 dhe 23.0;

(b) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X përmban gjithashtu të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin $\text{CuK}\alpha$: 12.3, 19.9, 21.6, 24.5, 26.3 dhe 31.6;

- (c) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X është në mënyrë thelbësore i lirë nga kulmet që kanë vlera 2-theta në rangun nga 10.8-11.8;
- (d) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X përmban të paktën një nga vlerat e mëposhtme 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin CuK_α : 12.2, 17.3, 19.9, 21.6, 24.5, 26.3 dhe 31.6, dhe ku difraksioni i pluhurit me rreze X në fjalë është në mënyrë thelbësore pa kulme që kanë vlera 2-theta në rangun nga 10.8-11.8;
- (e) modeli i difraksionit të pluhurit me rreze X përmban të paktën dy, tre, katër, pesë ose të gjitha vlerat e mëposhtme 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin CuK_α 12.2, 17.3, 17.5, 19.9, 21.6, 24.5, 26.3 dhe 31.2;
- (f) NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban rezonanca që kanë të paktën dy, tre, katër ose të gjitha vlerat e zhvendosjes kimike të mëposhtme siç shprehen në ppm në lidhje me TMS: 67.56, 54.60, 41.49, 30.70 dhe 13.77;
- (g) NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C e formës kristalore përmban të paktën dy, tre, katër ose të gjitha ndryshimet në zhvendosjen kimike ndërmjet rezonancës që ka zhvendosjen kimike më të madhe dhe rezonancave të tjera të zgjedhura nga 107.3, 120.3, 133.4, 144.2 dhe 161.1; dhe/ose
- (h) spektri i absorbimit ZnSe ATR-FT-IR i formës kristalore përmban të paktën dy, tre, katër, pesë, gjashtë ose të gjitha kulmet e absorbimit që kanë një vlerë të zgjedhur nga 1039, 1353, 1369, 1369, 1388, 2918, 2974 dhe 3088 cm^{-1} .

6. Një proces për përgatitjen e formës polimorfe kristalore të Përbërjes A të çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 5:



që përfshin hapat e:

- (a) tretjes së Përbërjes A në një tretës të përshtatshëm;
- (b) nëse është e nevojshme, ftohja e tretësirës që rezulton;
- (c) pritja e kohës së mjaftueshme që forma kristalore të kristalizohet, derisa kristalet të precipitojnë; dhe
- (d) filtrimin e formës kristalore në fjalë;
- ku
- (i) forma kristalore është *Forma II* polimorfe e pretendimit 2 ose 3 dhe tretësi është zgjidhur nga grupi i përbërë nga acetoni, acetonitrili, cikloheksani, heksani, dioksani dhe tretës të përzier të etanolit dhe acetonitrilit;
- (ii) forma kristaline është *Forma III* polimorfe e pretendimit 4 ose 5 dhe përftohet duke shtuar 1.3 mol ujë të dejonizuar në tretësirën e Përbërjes A në acetoni;
- (iii) forma kristalore është *Forma I* polimorfe e pretendimit 1 dhe e përftohet nga kristalizimi nga tretës organikë të përzieshëm me ujin që përmbajnë gjurmë uji si etanol, acetat etili, izopropanol, tert-butilmetileter, tetrahidrofuran, ujë ose avullim të ngadaltë të një tretësire të përbërjes së tretur ose në ujë ose acetat etili; ose
- (iv) forma kristalore është një përzierje e polimorfit kristalor të *Formave I* dhe *II* dhe tretësi është zgjidhur nga grupi i përbërë nga tolueni, diklorometani, 1-butanoli ose eter dietili.

7. Një proces për përgatitjen e polimorfit kristalor të *Formës III* të Përbërjes A sipas pretendimit 4 ose 5 me anë të një ri-llumi të Përbërjes A në ujë të dejonizuar dhe filtrimit.

8. Një proces për shndërrimin e polimorfit të *Formës II* në Polimorfin e *Formës III*, që përfshin mbajtjen e polimorfit kristalor *Forma II* të pretendimit 2 ose 3 në temperaturën e dhomës dhe të paktën 95% lagështi relative për një kohë të mjaftueshme për shndërrimin në një polimorf kristalor *Forma III* e çdonjërit nga pretendimet 4 deri në 5, ose nga një ri-llum i polimorfit *Forma II* në ujin e dejonizuar dhe filtrimin.

9. Një proces për konvertimin e polimorfrit të *Formës I* të pretendimit 1 në polimorf *Forma II* të pretendimit 2 ose 3 që përfshin një nga të mëmoshtmet:

(a) mbajtjen e një *Forme I* kristalorë në një temperaturë të ngritur nën pikën e shkrirjes së formës kristaline për një kohë të mjaftueshme për të shndërruar *Formën I* kristalorë në *Formën II* të polimorfrit kristalor në fjalë;

(b) pezullimin e një polimorfi kristalor të *Formës I* në një tretës të zgjedhur nga grupi i përbërë nga acetonitrili, cikloheksani, heksani, dioksani dhe tretës të përzier të etanolit dhe acetonitrilit, duke pritur kohë të mjaftueshme që forma kristalorë e pretendimit 2 ose 3 të kristalizohet, dhe filtrimin e formës kristalorë në fjalë; dhe

(c) ngrohjen e polimorfrit kristalor *Forma I* mbi pikën e tij të shkrirjes për të formuar një masë të shkrirë dhe ftohja e masës së shkrirë.

10. Proçesi i çdonjëri prej pretendimeve 6 deri 9, ku polimorfi kristalor rezultues i *Formës I, II ose III* është zgjidhur duke identifikuar polimorfin sipas modelit të tij të difraksionit të pluhurit me rreze X të vlerave 2-theta të matura duke përdorur rrezatimin CuK_α , ZnSe kulmet endotermike të spektrit të përthithjes ATR-FT-IR siç maten me DSC, TGA dhe/ose rezonancë siç matet me NMR në gjendje të ngurtë ^{13}C .

11. Një proces për mbajtjen e qëndrueshme të një polimorfi kristalor të *Formës II* të pretendimit 2 ose 3 që përfshin mbajtjen e kristalinës në fjalë në temperaturën e dhomës në një atmosferë të thatë.

12. Nje kompozim farmaceutik që përfshin nje polimorf kristalor të çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 5 dhe të paktën një ekscipient ose mbartës farmaceutikisht të pranueshëm, në mënyrë të preferuar, ku polimorfi *Forma II* ose *III* është i pranishëm në një sasi ndërmjet 1 mg dhe 100 mg dhe në mënyrë të preferuar ndërmjet 10 mg dhe 50 mg në formulimin, në mënyrë të preferuar ku formulimi është i granular.

13. Një proces për përgatitjen e një medikamenti bazuar në një formulim të polimorfrit kristalor të Përbërjes A, ku

(a) polimorfi kristalor është polimorf i *Formës II* të pretendimit 2 ose 3, i cili është i përshtatshëm për administrim oral dhe ku formulimi kompresohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në tableta; ose

(b) polimorfi kristalor është polimorf i *Formës III* i çdonjërit prej pretendimeve 4 deri në 5, i cili është i përshtatshëm për administrim oral, ku është i përzier me një ose më shumë ekscipientë si niseshteja e paraxhelatinizuar, celuloza mikrokristalorë, dioksidi i silikonit koloidal, dhe acidi stearik dhe përzierja mbushet në madhësinë 4, xhelatinë e forte, e bardhë opake, kapsula me dy pjesë për të siguruar 5 mg ose 10 mg polimorf *Forma III* për kapsulë, e cila mund të përdoret si një formulim oral për çlirim të menjëhershëm në traktin gastrointestinal .

14. Një formë polimorfe kristalorë e çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 5 për përdorim në trajtimin e një gjendjeje mjekësore që i përgjigjet trajtimit, përmirësimit, ose parandalimit me një agonist të receptorit muskarinik, ku gjendja është një sëmundje ose gjendje e lidhur me funksionin kolinergjik të dëmtuar, sëmundje ose gjendje në të cilën ka një çekuilibër në funksionin kolinergjik, sëmundje ose gjendje e lidhur me aktivitetin e dëmtuar të receptorëve të acetilkolinës, dhe sëmundje ose gjendje e lidhur me aktivitetin e dëmtuar të receptorëve M1 të zgjedhur nga demenca senile e tipit Alzheimer; sëmundja e Alzheimerit (AD); Demenca e trupit Lewy, sëmundja e përzier Alzheimer dhe Parkinsoni; Semundja e Parkinsonit; atrofia e shumëfishtë e sistemit; demenca multi infarkt (MID), demenca fronto-temporale; demenca vaskulare; goditja/ishemia, MID e kombinuar me goditje/ishemi/dëmtim të kokës; të kombinuara MID dhe AD; dëmtimi i kokës së njeriut; dëmtimi traumatik i trurit; dëmtime të kujtesës të lidhura me moshën; sindromi kalimtar i amnezisë globale; dëmtimi i lehtë njohës (MCI); MCI përçuese ndaj AD; mosfunksionim kognitiv duke përfshirë harresën, çrregullimet akute të konfuzionit, çrregullimet e mungesës së vëmendjes, çrregullimet e fokusit dhe përqendrimit; gjendje halucinative-paranojake, çrregullime emocionale dhe të vëmendjes; çrregullime të gjumit; deliriumi pas operacionit; efektet e padëshiruara të antidepressanteve triciklikë, efektet negative të disa barnave të përdorura në trajtimin e

skizofrenisë dhe sëmundjes së Parkinsonit; kserostomia, anomia, humbja e kujtesës dhe/ose konfuzioni; psikoza; skizofrenia, skizofrenia shoqëruese me AD, skizofrenia me fillim të vonë, parafrenia, çrregullime skizofreniforme; ankthi, çrregullimet bipolare, mania; stabilizimi i humorit; dëmtime njohëse pas heqjes së gliomave të caktuara; sinukleinopatitë; tauopati të tilla si tauopatia primare e lidhur me moshën; encefalopatitë kronike traumatike; sëmundja e Pick; paralizë progresive supranukleare; degjenerimi kortikobazal, diskinezia tardive; stresi oksidativ gjatë terapisë me oksigjen, p.sh., retinopatia e parakohshme; afazia; sindromi amnezik postencefalitik; encefalopatia e lidhur me sepsis; delirium i shkaktuar nga sepsis; demenca e lidhur me SIDA-n; dëmtimet në memorie në sëmundjet autoimmune duke përfshirë lupusin, sklerozën e shumëfishtë, sindromën Sjogren, sindromën e lodhjes kronike dhe fibromialgjia, splenomegalia, dëmtimet e kujtesës në depresionin atipik ose skizofrenina; deficitin kognitiv i shkaktuar nga kimioterapia; demenca alkoolike, deficite njohëse pas operacionit bypass dhe graftin, demenca e lidhur me hipotiroidizmin, dëmtime njohëse të lidhura me autizmin, sindroma Down, çrregullimet njohëse për shkak të abuzimit me drogën ose tërheqjes ndaj drogës duke përfshirë nikotinën, kanabisin, amfetaminën, kokainën, Çrregullimi Hiperaktivizues nga Mungesa e Vëmendjes (ADHD), dhimbja, reumatizma, artriti dhe sëmundje terminale; kseroftalmia, thatësia vaginale, thatësia e lëkurës; mosfunksionime imune; mungesa e transkarbamilazë ornitinë kongjenitale; atrofia olivopontocerebelare; simptomat e tërheqjes ndaj alkoolit; abuzimi i substancave duke përfshirë simptomat e tërheqjes dhe terapisë zëvendësuese, korea e Huntington; ataksia e Friedreich; sëmundja Gilles de la Tourette; sëmundjet e prionit; glaukoma; presbiopia; çrregullimet autonome duke përfshirë mosfunksionimin e lëvizshmërisë dhe funksionit gastrointestinale si sëmundje inflamatore të zorrëve, sindroma e zorrës së irrituar, diarreja, konstipacioni, sekretimi i acidit gastrik dhe ulçerat; inkontinenca urinare, astma, COPD; vonesa e shfaqjes së simptomave të AD në një pacient në rrezik për zhvillimin e AD, angiopatia cerebrale amiloide (CAA), amiloidoza cerebrale, hiperlipidemia, hiperkolesterolemia, skizofrenia joafektive, parafrenia, çrregullimet neurokrine dhe disrregullimi i marrjes së ushqimit, duke përfshirë buliminë dhe anoreksinë, kontrollin e peshës, obezitetin dhe inflamacionin; vëmendje të veçantë i kushtohet mbështetjes së imunoterapisë për çrregullimet inflamatore.

15. Forma polimorfe kristaline për përdorim sipas pretendimit 14, ku dozat ditore janë rreth 10 mg dhe 50 mg.

16. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 12, që përfshin më tej të paktën një përbërës shtesë farmakologjikisht aktiv, i zgjedhur në mënyrë të preferuar nga grupi që përbëhet nga: frenuesit e kolinesterazës, agonistët nikotink, prekursorët kolinergjikë dhe përforcuesit kolinergjikë, nootropikët, barnat antimuskarinike periferike, antagonistët muskarinikë M2, antagonistët e M4, agonistët e kundërt të benzodiazepinave, barnat antidepressante, agonistët sigma-1, antidepressantet, antideresantet triciklikë ose barnat antimuskarinike në trajtimin e sëmundjes së Parkinsonit (PD) ose depresioni, agjentët antipsikotikë dhe antiskizofrenikë, antagonistët dhe modulatorët e glutamatit, agonistët metabotropikë të receptorit të glutamatit, antagonistët NMDA, agonistët AMPA, acetyl-L-karnitina, inhibitorët MAO-B, peptidet dhe faktorët e rritjes, agjentë për uljen e kolesterolit, antioksidantët, inhibitorët beta GSK-3, ligandët Wnt, aktivizuesit PKC, inhibitorët beta- ose gama-sekretazë, agjentë degradues beta-amiloide, aktivizues të enzimave të përfshira në degradimin e beta-amiloidit si p.sh. aktivizues të neprilazines, enzimës degraduese të insulinës ose enzimës konvertuese të endotelines, agjentët beta-amiloide anti agregantë, agjentëvet kelatues, antitruapat dhe përbërjet imunoterapeutike kundër beta-amiloideve, patologjia e proteinave tau dhe/ose patologjia alfa-sinukleines, përbërje që lidhen me amiloidde, inhibitorët e bioksgjenazes, (COX)-2, barnat anti-inflamatore jo-steroidë, agjentët estrogenike, modulatorët e receptorëve estrogenike, neuroprotektorët steroidalë dhe farmaceutikët që bllokojnë rrotullimin.

(11) **11121**

(97) EP3052241 / 25/05/2022

(96) 14790760.4 / 03/10/2014

(22) 02/08/2022

(21) AL/P/ 2022/390

(54) **PAJISJE DHE MËNYRË E PËRMIRËSUAR E NDARJES SË DENSITETIT MAGNETIK**
13/10/2022

(30) 2011559 04/10/2013 NL

(71) Urban Mining Corp B.V.

Galileïstraat 32 L, 3029 AM Rotterdam, NL

(72) REM, Peter Carlo (c/o Galileïstraat 32 L, 3029 AM Rotterdam) ;BERKHOUT, Simon Peter Maria
(c/o Galileïstraat 32 L, 3029 AM Rotterdam)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)

(57)

1. Një ndarës i densitetit magnetik (20) që përfshin një kanal trajtimit (21) përmes të cilit në përdorim lëngu dhe grimcat e trajtimit magnetik që do të ndahen rrjedhin në drejtimin e rrjedhës (P), një pajisje magnetizimi (22) që është rregulluar të shtrihet në drejtimin e rrjedhës përgjatë të paktën një mur (23) i kanalit të trajtimit (21) në mënyrë që në përdorim të aplikohet një fushë magnetike në lëngun e trajtimit në zonën e ndarjes (S) të kanalit të trajtimit (21) për të vendosur një densitet të prerjes së trajtimit magnetik lëng për të ndarë grimcat në lëngun e trajtimit magnetik bazuar në densitetin e tyre, një laminator (4) përmes të cilit, në përdorim, lëngu i trajtimit magnetik futet në kanalën e procesit (21) për të rrjedhur i laminarizuar në drejtimin e rrjedhës përgjatë zonës së ndarjes (S), dhe një ushqim (24) përmes të cilit, në përdorim, një përzierje e lëngut të trajtimit dhe grimcave që do të ndahen futet në kanalën e trajtimit (21) për t'u bashkuar me lëngun e procesit të laminarizuar, magnetik, i karakterizuar në atë që ushqimi (24) përfshin një pajisje tërheqëse (25) th në përfshin një transportues me elementë tërheqës (31) që është rregulluar të lëvizë përgjatë drejtimit të rrjedhës (P) dhe që shtrihet përmes një kanali të furnizimit në kanalën e trajtimit (21).

